

**Akt Themelimi  
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar  
"4 SEASONS" SHPK**

Sot, më datë 08.10.2018, ortakët si më poshtë:

1. Hasan Abbaz, i biri i Mesud, lindur më 08.10.1967 në Tunizi dhe banues në Tiranë, identifikuar nga Letërnjoftimi me nr. G71008112P;
2. Noor Islam, i biri i Muzaffar, i datëlindjes 09.10.1974, lindur në Pakistan, me banim në Pakistan, identifikuar nga Pasaporte me nr. CR9991312;
3. Florenc Çepeli, i biri i Vasip, i datëlindjes 05.08.1985, lindur në Durrës, me banim në Durrës, identifikuar nga Letërnjoftimi me nr. I50805058A;

Vendosën të hartojnë këtë Akt Themelimi, me përmbajtje si më poshtë:

**NENI 1  
DATA E THEMELIMIT**

Sot, më datë 08.10.2018 themeluesit Hasan Abbaz, Noor Islam dhe Florenc Çepeli vendosën të krijojnë një shoqëri me emërtimin "4 SEASONS" SHPK

**NENI 2  
FORMA E SHOQËRISË**


Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

**NENI 3  
EMËRTIMI**

Emri i plotë i shoqërisë është "4 SEASONS" SHPK.

**NENI 4  
SELIA**

Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, Rruga "Dritan Hoxha", Kompleksi rezidencial "KARAVAN", Ndërtesa U3E21, kati 7, Ap. 17. Me miratim të organeve të saj Ajo



mund të ndryshojë selinë. Mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e R.SH apo jashtë saj.

## NENI 5 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë, ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

## NENI 6 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria “4 SEASONS” SHPK do të ketë si objekt të veprimtarisë:

- Agjenci udhëtimi;
- Çdo aktivitet tjetër tregtar që lidhet në mënyre të drejtpërdrejte ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## NENI 7 KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 120 (njëqind e njëzet) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortakët si më poshtë:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)
Hasan Abbaz	33.33	1
Noor Islam	33.33	1
Florenc Çepeli	33.34	1

Ky kapital është i ndarë në 3 kuota të zotëruara nga ortakët e shoqërisë.

Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.



**NENI 8  
ADMINISTRATORI**

Administrator i parë i shoqërisë do të jetë **Z. Florenc Çepeli**. Kohëzgjatja e mandatit të tij është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

**NENI 9  
DISPOZITA E FUNDIT**

Ky akt themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.

Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapokrijuar gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkangjitur.

**THEMELUES**

*Florenc Çepeli*



*NGOR ISKAM*

*HASAN ARBAZ*